



Ndërmarrja Publike Lokale  
**KASTRIOTI** Sh.A

Adresa: Rr. "Vashingtoni" pn - Obiliq  
Tel: +383 46666607; +383 48777624

Email: [nplkastrioti@gmail.com](mailto:nplkastrioti@gmail.com); web: [www.nplkastrioti.com](http://www.nplkastrioti.com)



Bazuar në Planin e Biznesit me nr prot 1143/23 si dhe Udhëzimit Administrativ për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik NR.01/2024 të nenit 4.1, 5.1 dhe 5.2, në Statutin e Ndërmarrjes me nr prot 1259/23 të nenit 36 paragrafi 36.3, vendimit me nr protokollit 1282/24 datës 30/08/2024 Ndërmarrja Publike Lokale "Kastrioti" Sh.A Obiliq me datën 02/09/2024 shpallë:

### KONKURS

#### Për plotësimin e vendeve të punës

#### PUNËTOR FIZIK (pastrues/e)

**Numri i punëtorëve: 2**

**Përgatitja shkollore:** diploma e shkollës fillore apo së mesme

**Përvoja e punës:** E dëshirueshme.

**Orari i punës:** i plotë

**Kohëzgjatja e kontratës:** 6 muaj punë provuese

**Vendi:** Obiliq

#### Punët dhe detyrat e punës:

- Kryen punët fizike për pastrimin e ndërtesave, objekteve publike të komunës së Obiliqit
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte duke respektuar kolegët
- Kryen të gjitha punët e caktura në kontratë
- Kryen dhe punë të tjera duke u bazuar në veprimtarinë e ndërmarjes dhe urdhërësave të eprorit
- Për punën e tij i përgjigjet drejtorit operativ.

#### Procedurat e Konkurrimit:

- Kandidati-ja për këto pozita duhet t'i dorëzojnë këto dëshmi:
- Dëshminë e kualifikimit,
- CV-në
- Kopjen e letërnjoftimit,
- Çertifikatën e cila dëshmon që nuk është i/e dënuar ( jo më e vjetër se 6 muaj),
- Dëshminë mbi përvojën e punës

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen përmes e-mailit zyrtar:

[konkursetnplkastrioti@gmail.com](mailto:konkursetnplkastrioti@gmail.com)

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë vendbanimin, numrin e telefonit kontaktues dhe e-mail adresën.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për testin me shkrim. Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Konkursi është i hapur nga data 02/09/2024 deri më 16/09/2024.

